


**GIOVANNI GENTILE
&
BENITO MUSSOLINI**



**DOKTRINA E
FASHIZMIT**



BOTIMET BRERORE

**GIOVANNI GENTILE
&
BENITO MUSSOLINI**

DOKTRINA E FASHIZMIT

**Përktheu: Vasil D. Alarupi
Mblodhi e përpunoi: Juxhin Halo, Eugen Lilo
© Botimet Brerore
brerore@outlook.com
2021**



VASIL DHIMITËR ALARUPI

PARATHËNIE

Djalosh Shqiptar,

Po të paraqes “Doktrinën e Fashizmit”, këtë Veprën madhështore, pjellj’ e trurit të të Madhit Benito MUSSOLINI.¹ Kjo vepër doktrinale, i dashur shok, është ajo q’ e rindërtoj Italinë me bazat më të shëndosha aq sa t’ a bëjë një nga më të parat Fuqi të mbëdha të këti dheu.

Kjo doktrinë po shtje themelet e një Qytetërimi të ri botëror, qytetërim’ i ndezur në Vatrën e Romës së Përherëshme, kundra barbarizmës shkatronjëse, erdhur nga kufit e largme t’ Asisë. Me karakter të përbotëshmë, se e volitëshme me kontingjenca vëndi dhe kohë, është një “e mirë” për gjith popujt; është një pllan që gjith kombet po marin për rindërtimin e tyre shoqror dhe politik; është

Doktrina triumfonjëse e shekullit XX dhe prej së cilës pritet shpëtim’ i qytetërimin oksidental, shpëtim i kësaj Evrope të shqetësuar dhe shkatruar, shpëtim’ i Botës së tërë.

Parimet themelorë të kësaj Doktrine janë: realiteti dhe faktet të forcuar prej një karakteri shëmbëllor. Është jeta e gjallë, e vërteta e kulluar.

I panjohur, i keq kuptuar, i injoruar krejtësisht, se keq i propaganduar ng’ armiqt’ e tij të pabesë – i urrejtur shumë herë dhe prej shqiptarësh, fashizmi ndërtonjës duhet jo vetëm të kuptohet fare mirë, por edhe të zerë rrënjë në zemrën e ç’do të riu arbror.

¹ Dhe e Giovanni Gentile, në rrafshin filozofik. Shënim i redaktorit.

Ti, i dashur shok, q' e di historinë, që lëçit dhe kupton në 'të, ke mësuar se përpara ardhjes në fuqi të Fashizmit, Italia, kish filluar të rrokullisej në greminën e tmershme q' i kishin hapur partit' e politikaxhinjvet: liberalë, masonë, demokratë dhe bollçevikë.

Ardhi Mussolini për fatin e këti kombi të madh; doli burri m' i madh i kësaj kohe. Gjenia e Tij krijoi mistikën më të fortë të kohëve. Preku palcën e kombit – djalërinë; e mori këtë, e punoi, e gatoi, i dha frymën e forcën e shpirtit 'Tij. I dha një karakter, një kurajo, një kulturë, e pajosi me cilësitë e plota të një burri. Pastaj krijoi, ndërtoi, forcoi, e mori Italinë Fashiste dh' e vuri në vëndin e nderit në Skenën e Botës.

Tani pors i mbi një libër t'hapur parasysh, shohim Veprën e gjallë të kryer prej Fashizmit. Është një Vepër gjigande. Fashizmi e ndryshoj të tërë strukturën kombëtare t'Italisë: shoqrore, politike, fetare, morale, ekonomike, financiare, ushtarake, psikologjike, letrare.

Mussolini u ka dhënë shpirttrave italianë, trimërinë. Skuadra ajrore e Balbos kalon Atlantikun dyke u nisur prej Italie, n'Amerikë. Konti Ciano, ministër, prin "Disperata-n" dhe zbret në Adis-Abeba, nwn zjarin e armikut. Italia mban rekorde të shumtë n'aviacion dhe më të shkëlqyerin të shpejtësis, me më tepër se 700 km n'orë. N'automobilizmë dalin të parët. Flota ajrore italiane është e para në Botë si nga materiali ashtu dhe nga personeli. Ushtria e shkëlqyer.

Marina luftarake ariti radhët e para; ajo tregëtare njëlloj. Në sportet del e para. Mussolini ka thënë: "Mburem të jem ay që jam, d.m.th, një njeri që para se t'u diktojë sakrifica të tjerëve, i'a dikton vehtes dhe para se të

kërkojë disiplinën për të tjerët, kësaj discipline i bindet.” Shëmbëll e shkëlqyer, prej së cilës popull’ i tërë nxjer frymëzimin dhe shtytjen e veht. Kujtoj: Bruno e Vittorio Mussolini, si luftëtarë n’ Afrikë, etj, etj.

Popullit i diktoi një harmoni të plotë. Kapitali dhe puna janë pajtuar me anë të korporatave. Me këtë i tregon Botës dhe kapitalistëve, pronarve dhe tregëtarëve, se Fashizmi nuk pret disiplinë vetëm nga punëtorët. Është pastruar shpirti materialist. Shteti ka marë të drejtën t’edukojë brezat e arthmë, dyke përfshirë tërë rinin e dy gjjinive në: “Opera Nazionale Balilla”. Punëtorët gjejnë prehje, forcohen fizikisht e moralisht në: “Opera Nazionale Dopolavoro”. Në fushën ekonomike dhe industriale, fashizmi i ka fituar të gjitha luftrat. Mbi kënetat vdekjeprurëse u ndërtuan qytete; tani bëhet bereqeti i bollëkshëm për begatin e Kombit.

U krijuan autostrada, udhë, godina, stadiume, fabrika. Në fushën e shkencave, Fashizmi, për t’u çliruar nga zgjedha e huaj, ka krijuar: “Consiglio Nazionale delle Ricerche”. Kundrejt Botës Italia ka një politikë energjike dhe të denjë; marrëdhëniet ekonomike, politike, tregëtare dhe ato të miqësis janë të patundëshme. Nderi kombëtar është në vëndin e tij. Politika demografike e radhës së parë.

Mbrojtja shoqrore n’ Italin Fashiste është’ e para në Botë dhe shëmbëlllore. “Opera Nazionale per la protezione della Maternita e dell’ infanzia”. Luftë kundra tuberkullozit dhe të tjerave sëmundje shoqrore. Luftë kundra papunsis. Assistenza mjekësore dhe farmaceutike në favor të punëtorëve. Masa mbrojtjeje dhe parashëkimi në favor të punëtorëve intelektualë. Janë ngritur senatoriume shëmbëllorë, etj, etj.

Është e pamundur të parashtrijmë në këto kohë tepër të kufizuara tërë veprat e Italisë Musoliniane.

E aritur në një shkallë të tillë, e ngushtuar, e teptisur prej bijvet saj në tokën e veht, Italia deshi dhe një vënd në Diellë. Mussolini thiri djalërinë. Diçka i tha. Dhe ajo më këng'e me pushkë u tur n' Afrikë. Së pari mori hakën e gjyshëve. Pastaj i siguroj Romës së Perherëshme, Perandorinë.

Ndër kohë Bota e tërë e udhëhequr prej flamurtarësh hipokritë, kërkoj t'a mbytë Italin Fashiste me anë të sanksioneve. Kundërshtarët e pabesë të fashizmit dyke i mohuar ç'do mundësi, bënëin pllane, Mussolini punë. Thuhej at'here – theshin kompetentët (!) – që nga Sallonet e Evropës se varr'i Fashizmit është n' Abisini; thuhej se: as për dhjetë vjet, ushtëria Italiane s'ka për t'hyrë n' Adis-Abeba.

Predikonin se Përçi Afrikan, Perandor' i skllëvërve...do të tmerojë italianët! Kur thuheshin këto, nëpër sallonet evropianë, atje tej n' Afrikë, legjionet e Mussolini-t të drejtuar prej Badoglios dhe Grazianit, ecnin gjithnjë përpara. Flitej dhe për "bllof", por nuk dihej kush bllofonte. Dhe shastia i ra Botës, atë minutë kur radjoja, shpikj'e Marconi-t, u lajmëroj kombësivët, hyrjen triumfale n' Adis-Abeba.

Fashizmi nuk bëri çudira, por realizoi punra konkrete. Sa krenarë ishin dhe shqiptarët atë minutë! Mbret' i tyre edhe nj'herë i dha botës një mësim të lartër.

Roma e Përherëshme Dritëdhënëse, dyke ndriçuar popujt, po lufton barbarizmën asiatiche, bollçevizmën shkatrimtare, e cila s'njeh Atdhe, familje, fe, as pronjë as nisjativë vetiake; s'njeh kufi as krenari race dhe kombësie. Me luftën e kllasave kërkon të shkatrojë qytetërimin e sotmë, për të ngritur mbi gërmadhat e tij botën e saj të çmëndur.

Minë dhe buallë, qengjin dhe ujkun nuk i shquan. Zulun' e Afrikës dhe Evropjanë, qytetërimin oksidental dhe barbarizmën asiatiche i mer dhe i fut në një thes. Prandaj shohim në skëterën bollçevike, tmerin dhe krimin, skllavërinë dhe mizerjen të sundojnë, dhe shumicat të shfarosen porsu bisha të këqia.

Fashizmi Atdhenë e vë në krye, Kufit i mburuan gjer në pikën e fundit të gjakut. Fenë e nderon dh'e përkran pa shquarësi të veçantë. Familjen e konsideron si gjënë më të shenjhtë brënda Kombit. Nisjativa vetiake përkrasht. Shumicës punëtore Shteti i jep tërë kujdesin e tij, pa bërë ndryshime kllasash, të gjithë me punën e tyre kontribuojnë në paravajtjen e përbashkët Kombëtare.

Sikundër për Italinë doli shpëtimtar' i saj Benito Mussolini, ashtu dhe për Shqiprinë t'onë "Kombin më të moçëm" erdhi Mbreti i Madh ZOG I.

Miqësia e shekujvet të më parëshmë u ringjall. Dy burra të Mbëdhenj në krye të dy kombeve, Itali-Shqipri, ç'mund të bënin veç se të merreshin vesh midis tyre për të ndërtuar?

Mussolini i ndau qiqrat kundrejt Botës dhe shumë politikaxhinjvet kokëthatë që më 1928 me këto fjalë të deklaruaruara në Senatin italian: "Shqipëria e di se mund të

shpresojë në miqësin' e Italisë dh' e di se kjo miqësi është krejtësisht leale, thellësisht e sinqertë e se përpigjet deri në skrupull që të mos kryejë asnjë vepër e të mos thotë asnjë fjalë që mund t' interpretohet dhe prej njerëzvet në keqbesim, si një ndërhyrje në punët e brendëshme të Shtetit shqiptar. Italia ka një interes të vetëm themelor, d.m.th. që Shteti shqiptar, i udhëhequr nga dora e fortë dh' e urtë e një burri me cilësira të larta si ZOGU, t'a përforcojë për herë më tepër njëjësinë e tij të brendëshme dhe autonomin' e tij kundrejt vëndeve të huaj. Lidhjet midis Italisë e Shqiprisë mund të quhen me të drejtë shekullore dhe tradicionale”

Dhe Mussolini fjalët e tij i vuri në zbatim.

Kush do të hedhë një sy mbi të shkuarën e afërme të vëndit t'onë dhe të shohë gjendjen e vërtetë t' at'herëshme, do të bindet për gjenin' e Prijësit dhe Fatosit ZOG I. Pesë shekuj robërije të huaj e kishin shtypur Arbrinë. Vëndi ynë u la prapa kur të tjerët përparonin. Kur më 1912 fituam të “drejtën” t'onë dhe filluam punën, erdhnë trazirat botërore.

Pas 12 vjet të tjerë përsëri rifilluam punën por kjo punë nuk ish veç se përçarje dhe grindje, shkatrim e dënim për vëndin t'onë. Edhe te ne zunë të shkumbëzojnë partit' e politikaxhinjvet. Por fat' i Shqipris ishte i shkrojtur, n'a erdhi dhe neve Prijësi. Me të marrë në dorë drejtimin e Shqiprisë, ZOG I, i dha këtij vëndi krenarin' e tij të brendëshme dhe të jashtme.

Në 13 vjet regjimi Zogist, Shqipria e ndroi fytyrën krejtësisht. Kur mendojmë karakterin dhe zakonet e këqia prapanike të trashëguara nga sundimi shekullor i huaj, kuptojmë shumë gjëra. Në këtë vënd reformat q' diktoi Mbreti ynë, për t'a bërë të njëjshmë me botën e qytetëruar,

nuk ishin gjëra të vogla, por vepra vigane. Personi i Prijësit t'onë shquhet mirë si politik i radhës së parë, diplomat i matur, ushtar trim, Mbret gjenial.

Mussolini, një nga të parët e çmon Mbretin t'onë: "Prijës i shkëlqyer me një dorë të fortë, dhe të urtë, një burrë me cilësira të larta."

Miqësin' e saj për Aleaten e Madhe, Shqipëria e ZOG I e provoj në shumë raste dhe sidomos në rastin më të veçantë të kohës sanksioniste. Pastaj me njojtjen e Imperatoris Fashiste. Populli ynë e shpreu simpathin' e tij të thellë edhe gjatë vizitës së Kontit Ciano. Ishte dh' ay një rast manifestimi dhe shprehjeje të gjallë i miqësis së ngushtë, të sinqert' e të thellë q' ushqen për aleaten e përtej detit, nga e cila na kanë ardhur aqë prova kujdesi dhe bujarie për të mirën e e Shtetit t'onë të vogël, por të lirë dhe kryelartër.

"Mbi relatat italo-shqiptare do t' ju them se s' ka gjë më të natyrëshme në botë se miqësia në mes të dy popujvet t'onë. Nga pozita gjeografike dhe nga gjendja ekonomike e të dy vëndevet është krejtësisht e natyrëshme që raportet t'ona të jenë vllazërore. Miqësia e popullit t'Em dhe ajo e Imja personale është' e madhe për Italinë Fashiste, në krye të së cilës gjendet një njeri i Madh që ka ditur t'i japë Italisë një lavdi që tash më është e pohuar në tërë botën. Është një detyrë patriotike e ju gazetarëvet që të bëni ç'ka është e mundur që kjo miqësi të jet' e përherëshme.

Përfitoj nga rasti për t' ju shprehur gëzimin t' em për prezencën e Kontit Ciano, vizitë që ka një kuptim shfaqjeje miqësie e që nënvizon relatat intime në mes të dy popujvet t'Onë, të mbështetura mbi ndjenjat e përzemërta të të dy popujvet."

Këto janë deklaratat që Naltmadhnia Mbreti t'onë u bëri gazetarëve italianë me rastin e vizitës së Kontit Ciano. Këto konfirmojnë ndjenjën e miqësis së thellë dhe leale që bashkojnë Kombin t'onë me aleaten e madhe, të bazuara edhe mbi traktatin e 22 Nëntorit 1927 dhe mbi akordet e 19 Marsit 1936. Vëndi ynë e ka çmuar kontributin e dhënë nga an'e Italisë për përparimin dhe mirëqënien e Shqiprisë.

Pa shëkuar më tutje, por që prej Skënderbeut gjer te ZOG I, shqiptarët nuk kanë bërë veç se madhërin e begatin e kombeve të huaj. Ku themeluan dinastira mbretrore, ku princore, u-bënë kryetarë Shtetesh të fuqishme, gjeneralë të famëshme; siguruan dhe forcuan pamvarësi kombesh. Në letrësi, në fe, n'artet, vëndi ynë i ka dhënë botës trurë të famëshme, por që mjerisht gjer sot historia na ka kobuar.

Kjo na provon fuqinë dhe mundësin' e racës s'onë dhe konfirmon shumë gjëra q' historia ka shtremtuar. E mrekullushme do t'ish e arthmja e racës dhe e Kombit Shqiptar, e denjë e së shkuarës sikur kujdes' i Shtetit të vinte i tëri n' organizimin e djalërisë. Çudira faktesh do të bënte raca jonë. Këto i themi me forcë dhe krenari. Vetëm dorëheqësit, të lënë, vetëm ata të kllanikut nuk mund t'i shkojnë ndër mënd.

Organizimi lejon bashkimin e forcave të përçara në një trup të vetëm. Kusuri është kotësi. Forcën e tija Kombi e ka në djalërin' e veht. Ay shtet që neglijgon, s' kujdeset ose braktis djalërinë, nuk mund t' ecë përpara. Janë të fortë, të begatëshme dhe ecin përpara vetëm ata q' e kanë kuptuar dhe zgjidhur problemin e djalërisë dyk'e

organizuar dhe pajosur këtë me një spiritë e një frymë nacionaliste të shkëlqyer.

Shëmbëll kemi Italinë. Populli i tërë duhet organizuar. Dhe një popull sot më tepër se kurdoherë: një frymë, një shpirt, një trup duhet të jetë, dhe kur është kështu, ay popull sa do i vogël nga numuri, është i madh nga shpirti, prandaj dhe m' i fortë se popuj të shumtë por pa shpirt.

Nuk duhet t'allavitemi. Në kohën t'onë edhe mëndja duhet të shpejtohet. Mëndja dyke çkoklavitur elementat themelore dhe të rjedhëshim t'evolucionit të këti shekulli, lejon të largohen provat e shastisura dhe fatkeqe, dyke i mësuar popullit atë q'është e mundur, me qënë se kjo mundësi pajtohet me evolucionin dh' atë që nuk është e mundur me qënë se bie në kundërshtim me shtrëngesat e kohës.

Kombe të shumtë për pllan dhe bazë rindërtimi të tyre po marin Fashizmin. Është Doktrina modele e këti shekulli. Porsi gjetkë edhe te ne ndodhen mjaft kokëtrashë që mjafton të dëgjojnë fjalën “Fashizmë” të tmerohen si prej murtaje. Ah! Injorancë, injorancë, armike e tmershime e njërzimit!

Bazën për organizimin – sa të nevojshim dhe të vlefshëm – e djalëris s'onë dhe të rindërtimit të Kombit duhet t'a marim dhe ne prej Fashizmit. Përshtatja e drejt për drejtë, është vepër prej paraziti. Por nga “Doktrina e Fashizmit” duhet të marim elementat themelore që pajtohen me karakterin, zakonet dhe nevojat t'ona kombëtare.

Pastaj këtyre t'u shtojmë krijimet Zogiste dhe për shekullin t'onë për Shqiprinë t'onë të përbëjmë

“Doktrinën shëmbëllore Zogiste” që të jet e vlefshme për brezat e tanishmë dhe t’arshmë.

Musolini na thotë: s’ka doktrinë që të pretendojë në një origjinalitet të krejtë dhe se, edhe veht Fashizmi ka nxjerë nga gërmadhat e doktrinave liberale, socialiste, demokratike, elementat që kanë akoma një vlerë jetike dyke flakur tej kusurin.

Me një djalëri t’organizuar në Shtetin Unitar Kombëtar, me disiplinimin e të gjitha rymave dhe energjive, me forcimin e ndjenjës Kombëtare, Shqipria ka për t’u bërë një Komb model. Natyra e ka pajosur me cilësi të rralla.

Kemi një Mbret të Madh, gjenial, jemi pra të sigurt se do të kryejmë punra të mbëdha. Të gjith rreth Mbretit t’onë, me punë, bindje dhe ndërgjegje, që t’a bëjmë Shqiprinë – e famëshme qëmoti – më të lavdërueshme paskëtaj, nën drejtimin e ndritur të Fatosit ZOG I.

Vasil D. Alarupi
Korçë, Gusht 1937

KAPTIN' E PARË

IDETË THEMELORE

Shkruar nga Giovanni Gentile²

² Shënim i redaktorit

1. Fashizmi si Fillosofi

Si ç' do koncept i pastër politik, fashizmi bashkon mendimin me veprimin. Është një veprim i frymëzuar prej një doktrine. Kjo doktrinë është lindur nga një sistem i rjedhur prej forcash historike, me të cilin qëndron në lidhje të ngushtë dhe i shkakton gjallërin' e veht. Pra, ka një formë të volitëshme me kontingjenca vëndi dhe kohe, por ka njëkohësisht dhe një përmbajtje ideale e cila e ngreh në një shkallë vërtetësie nga më të lartat n' historin e mendimit.

Nuk do të ish e mundur të veprohej shpirtërisht mbi botën, si vullnet njerëzor, që sundon të tjerë vullnete, pa një kuptim të realitetit t' hëpërhëshmë dhe të veçantë mbi të cilin duhet vepruar, edhe t' ati tjetrit realitet të gjithëmonëshmë dhe botnor të cilit i pari i detyrohet për qënien dhe jetën e veht. Për të njojtur njerzit, duhet njojtur njeriu; dhe për të njojtur njerinë, duhet njojtur realiteti dhe ligjet e tij.

S' ka koncept Shteti që të mos jetë me themel një koncept i jetës. Është një fillosofi ose një intuitë, një sistem idesh që kthehet në një ndërtim llogjik ose që përmbledhet në një shëkim ose në një besim, por është gjithmonë, së paku virtualisht, një koncept organik i botës.

2. Kuptimi shpirtor

Fashizmi do të mos kuptohej në shumë nga manifestimet e tija praktike, qoftë si organizim partije, si sistem mirë-ritjeje, ose si disiplinë, po të mos çmohej në veprimin e kuptimit të përgjithëshmë të jetës. Ky koncept' është shpirtor. Për fashizmin, bota nuk është ajo botë

lëndore që shfaqet mbi sipërfaqen, ku njeriu është një individ i ndarë nga gjith të tjerët, dyke rrojtur në vehte, edhe i qeverisur prej një ligji natyral i cili vetiu e shtyn të jetojë një jetë qejfi egoist dhe të hëpërhëshme.

Njeriu i fashizmit është një individ i cili është Komb e Atdhe, një ligj moral që bashkon individët edhe brezat në një traditë dhe në një mision, që zhduk instiktin e jetës së kufizuar në rethin e ngushtë të qejfit, për të vendosur brenda detyrës një jetë më të lartër, të çliruar nga kufit' e kohës dhe t'hapësirës: një jetë ku individi, me therorin' e vehtes tij, me sakrificën e interesave vetiake edhe me vdekjen, kryen këtë jetë krejt shpirtore e cila i jep vleftën e një burri.

3. Kuptimi pozitiv i Jetës si Luftë

Është pra një kuptim shpirtor, i lindur nga reaksioni i përgjithëshmë i shekullit të tanishmë kundra pozitivizmit lëndëror dhe të degjeneruar të shekullit XIX-të. Një koncept i tillë është antipozitivist, por pozitiv: as dyshonjës, as agnostik, as pesimist, as lehtazi optimist, sikundër janë përgjithësisht doktrinat (të gjitha negative) që vendosin qendrën e jetës përjashta njeriut, i cili, me anën e vullnetit 'tija të lirë, mund edhe duhet të krijojë botën e veht.

Fashizmi do që njeriu të jet' i shkathët dhe i lidhur me veprimin me të gjitha energjit e tij: ay e do burrërisht njohës të çdo vështirësie të vërtetë dhe gati t'i përballë. Jetën e kupton si një luftë dhe gjykon se i përket veht njeriut të zotrojë një jetë me të vërtetë të denjë për të, dyke krijuar para së gjithash në vehten e tij, veglën (fizike, morale intelektuale) për t'a ndërtuar. Kjo është e vërtetë

për vehtë individin, për kombin dhe për njerëzimin. Q'aty del vlefata e lartër e kullturës në të gjitha format e saj (art, fe, shkencë) edhe rëndësia shumë e madhe e edukatës. Q'aty del gjith ashtu, edhe vlefata kryesore e punës, me anë të së cilës njeriu triumfon mbi natyrën edhe krijon botën njerëzore (ekonomike, politike, morale, intelektuale.)

4. Kuptimi moral

Ky kuptim pozitiv i jetës është pa dyshim një koncept moral. Ay përmbledh të tërë realitetin, si dhe tërë aktivitetin njerëzor q'e sundon. As një veprim nuk i shpëton gjykimit moral, as gjëje në botë nuk mund t'i hiqet vlefata që kanë gjith farë sendesh në lidhje me qëllimet morale.

Prandaj, jeta, ashtu si ç'e gjykon fashisti, është serioze, e rreptë, fetare: ajo jetohet e tëra në një botë që mbahet nga forcat morale dhe përgjigjëse të mendjes.

Fashisti e urren jetën e rehatëshme.

5. Kuptimi fetar

Fashizmi është një koncept fetar, i cili e shquan njerinë në lidhjen e tij sublime me një ligj të lartë, me një Vullnet objektiv q'e kalon individin si të tillë dhe e ngreh në dinjitetin e një anëtari ndërgjegjës të një shoqrie shpirtore. Ata që, në politikën fetare të regjimit fashist, nuk kanë parë veç se një çestje krejt oportuniteti, nuk kanë kuptuar se fashizmi është jo vetëm një sistem Qeverie, por akoma, edhe para ç' do gjëje, një sistem mendimi.

6. Kuptimi realist

Fashizmi është një koncept historik, në të cilin njeriu nuk është ay që ka aritur të jetë veç se me anë të zhvillimit shpirtor në të cilën mer pjesë, në grupin familjar dhe shoqror, në kombin edhe n'historinë në të cilën gjith kombet bashkëpunojnë. Q'aty del vlefata e lartër e traditës në kujtesën, në gjuhën, në zakonet, në ligjet e jetës shoqrore. Në përjashtim t'historisë, njeriu nuk është as gjë.

Prandaj fashizmi, është kundër të gjitha shqetësimeve vehtësore, me bazë lëndore, lloj shekulli i XIX-ë; prandaj është dhe kundër të gjitha utopive dhe çpikjeve të reja Jakobine. Ay nuk beson se "lumtëria" është e mundur mbi dhe, si ç'i pëlqente letrësis s'ekonomistëve të shekullit XVIII-ë; ay largon të gjitha konceptet telleologjike larg vehtes – për të cilat në një periudhë të historisë do t'ketë një systemim të fundmë të racës njerëzore.

Kjo do të thotë të vendosesh jashtë historisë dhe jetës që ndodhet në ndryshim të vazhduarshmë. Në praktikë fashizmi kërkon të jetë një doktrinë realiste; kërkon të zgjidhë vetëm problemet që ngrihen brënda historisë e që në vehte sugjerojnë zgjidhjen e tyre. Për të vepruar mes njerëzve – ashtu si në natyrë – duhet hyrë në proceset e realitetit e të mbërthehen forcat vepruese.

7. Anti-individualizmë dhe liri

Anti-individualist - konceptsjoni fashist është për Shtetin; edhe për individin për aq sa ky përkon me Shtetin, që është ndërgjegje dhe Vullnet universal i njeriut në ekzistencën e tija historike. Është kundra liberalizmës – q'u lind si reaksjon ndaj absolutizmës, edhe q'e ka mbaruar

funksionin e saj historik, që kur se Shteti ka aritur të jetë vetë ndërgjegjia edhe vetë vullneti i popullit. Liberalizma mohonte Shtetin për interes t'individit; fashizmi e ripohon Shtetin si të vërtetin realitet t'individit. Dhe, në se liria duhet të jetë atributi i njeriut të vërtetë dhe jo e marionetës të shastisur te e cila mendonte liberalizma individualiste, fashizmi është për lirinë.

Është për të vetëmen liri që mund të jetë gjë serioze, lirin' e Shtetit dhe t'individit brënda Shtetit. Në fakt, për fashistin ç' do gjë qëndron brënda Shtetit, dhe as gjë tjetër njerëzore ose shpirtrore nuk mund të gjendet dhe aq më tepër nuk ka vleftë, në përjashtim të Shtetit. Në këtë kuptim, fashizmi është tërësor, edhe Shteti fashist, synthezë dhe njëjësi e ç' do vlefte, interpreton, zhvillon dhe sundon të gjithë jetën e popullit.

8. Anti-socializmë dhe Korporativizmë

As individë e as trupa (partira politike, shoqirra, sindikata, kllasa) në përjashtim të Shtetit. Fashizmi pra, bije në kundërshtim me socializmën, e cila e nguros lëvizjen historike në luftën e kllasave, dhe nuk e njeh njëjësin e Shtetit i cili tret kllasat në një realitet të vetëm ekonomik dhe moral; gjith ashtu është edhe kundër sindikalizmës së kllasave. Po fashizmi do që, në qerthullin e Shtetit, nevojat e vërteta që ngjallnë lëvizjen socialiste dhe sindikaliste, të miren parasysh, dhe këto i vë në vleftë me anë të sistemit korporativ ku gjith këta interesa pajtohen në njëjësin e shtetit.

9. Demokraci dhe Komb

Individët përbëjnë kllasa, sipas llojit t'interesave; ata janë sindikuar sipas aktiviteteve të ndryshme ekonomike të bashk-interesuar; por janë para së gjithash dhe mbi të gjithash, Shteti. Ky, nuk është as numuri as shuma e individëve që përbëjnë shumicën e një populli. Nga kjo gjë fashizmi bje në kundërshtim me demokracinë e cila e njehëson popullin me numurin me të madh individësh, dhe e ul në këtë nivel. Me gjithë këtë fashizmi është forma më e kulluar e demokracisë. Të paktën, në qoftë se populli kuptohet, ashtu si ç' duhet të jetë, në pikëpamje cilësie dhe jo sasie, në qoftë se jep kuptimin e idesë më të fuqishme sepse është më morale, më e përshtatëshme, më e vërtetë, e që mishërohet në popullin si ndërgjegje dhe vullnet i një numuri të vogël ose dhe i një t'vetmi, porsia një ideal që fillon të realizohet në ndërgjegjen edhe në vullnetin e të gjithëve. Të gjithë atyre që, në bazë të natyrës ose t' historisë përbëjnë etnikërisht një komb dhe ndjekin një vijë të vetëme zhvillimi dhe formimi shpirtëror, si një ndërgjegje e vetme dhe një vullnet i vetëm. Nuk është fjala as për racë, as për ndonjë vënd gjeografik të caktuar, po për një grup që përjetësohet historikisht, për një shumicë të bashkuar prej një ideje e cila është një vullnet jetese dhe fuqije: ide që ne do t'a quhajm gjith ashtu ndërgjegje të vehtvehtes, ose vehtdije.

10. Kuptim' i Shtetit

Kjo vehtdije m'e lartër është komb ndërsa dhe Shtet. Nuk është kombi që krijon Shtetin, sikundër ngjiste në konceptin e vjetër natyralist, i cili shërbente si bazë e publicistëve të Shteteve nacionaliste të shekullit XIX-të.

Përkundrazi, kombi është krijuar prej Shtetit, i cili i jep popullit, që njih bashkimin moral të vet, një vullnet dhe q'aty një qënie të vërtetë. E drejta e një kombi për pamvarësin e veht, nuk është themeluar mbi ndërgjegjen letrare dhe ideale t'ekzistencës së 'tija, edhe aq më pak mbi një gjendje pak a shumë të pa-ndërgjegjshme dhe të pa-shpirtme, por mbi një ndërgjegjie aktive, mbi një vullnet politik vepronjës dhe gati të provojë të drejtën e vehtë: d.m.th mbi një lloj Shteti pothuaj "in fieri". Shteti si vullnet etik botnor, krijon të drejtën.

11. Një shtet moral

Kombi, si Shtet, është një realitet moral, që gjendet dhe jeton në masën e zhvillimit të vet. Mos veprimi për të është vdekje. Shteti pra nuk është vetëm një autoritet që qeveris dhe u jep një formë ligjore dhe një vleftë jete shpirtore vullneteve individuale; por është edhe një fuqi që vë në vleftë vullnetin e tij përjashta, dyke e bërë të njihet dhe të respektohet, d.m.th dyke provuar, me anë të fakteve, botërimin në të gjitha manifestimet e nevojshme të zhvillimit 'tij. Pas kësaj, një organizim dhe zgjerim së paku virtual. Kështu, Shteti mund të njehësohet me natyrën e vullnetit njerëzor, e cila nuk njih kufi në zhvillimin e vet, dhe provon pafundësin dyke u realizuar.

12. Përmbajtja e Shtetit

Shteti fashist, që është forma më e lartër dhe më e fuqishme e vehtdijes, është një forcë por një forcë shpirtërore, një fuqi që përmbledh të gjitha format e jetës morale dhe intelektuale të njeriut. Nuk mundet pra të kufizohet vetëm në veprime të thjeshta rregulli dhe mbrojtjeje sikundër e do liberalizma. Nuk është një

mekanizmë e thjeshtë që kufizon sferën e të vetëquajturave liri individuale. Është një formë, një rregull i brendëshëm dhe një disiplinë e të tërë njeriut: ajo ngulet si në vullnetin dhe në inteligjencën. Parimi i tij – frymëzim qendror i personalitetit njerëzor që jeton në shoqërin civile – futet në shpirtin e individit, edhe në zemrën e njeriut vepronjës si n’ atë të mendonjësit, t’ artistit si n’ atë të dijetarit: është shpirti i shpirtit.

13. Autoriteti

Fashizmi nuk është vetëm legjislator dhe themelonjës institucionesh; është gjith ashtu edukonjës dhe udhëheqës i jetës shpirtërore. Ay kërkon të rindërtojë jo format e jetës njerëzore, por përmbajtjen e saj: njerinë, karakterin, besimin. Dhe për këtë qëllim, kërkon një disiplinë dhe një autoritet që ngulen në mendjet dhe mbretërojnë mbi to pa përçarje. Prandaj shënja e tij është “Fascio del Littorio”, simboll’ i bashkimit, i forcës dhe i drejtësisë.

KAPTIN' E DYTË

DOKTRINA POLITIKE DHE SHOQRORE

**Shkruar nga Benito Mussolini dhe
redaktuar nga Giovanni Gentile³**

³ Shënim i redaktorit

1. Origjina e Doktrinë

Kur, n' atë muajin e largmë të marsit 1919, në shtyllat e "Popolo d'Italia" ftonja në Milano ata q'u kthyen nga lufta pas "ndërhyrjes" dhe që më kishin ndjekur që në fillim të krijimit të Fashiove revolucionare – ngjarë më 1915 -, as një pllan i veçantë doktrinal nuk gjendesh në mëndjen t'ime. Solla përvojën e jetuar të një doktrine të vetëme: atë të socializmës së 1903-1904-trës gjer në dimrin e 1914-tës, d.m.th nj'a dhjetë vjetësh pothuaj. Përvojë partizani dhe shefi, por jo përvojë doktrine. Doktrina ime edhe n'atë kohë, kish qënë doktrina e veprimit.

Një doktrinë e vetëme e socializmës, e pranuar botërisht, nuk gjendej më, që më 1905 kurse filloj në Gjermani, lëvizja revizioniste e drejtuar prej Bernstein-it, dhe kur për kundër n'ojnën alternative të tendencave u-formua një lëvizje e mëngjërt revolucionare, e cila, n'Itali, nuk e kapërxeu kurrë fushën e frazave; kurse për socializmën ruse kjo ishte një fillim i bollshevizmës.

Reformizmë, revolucionarizmë, qendrizmë, edhe vetë jehonat e kësaj terminollogjie janë shojtur, kurse në lumin e madh të fashizmit do të gjeni rjedhjet e Sorel-it, të Peguy-s, të Lagardelle-it të Lëvizjes Socialiste, dhe të trupës së sindikalistëve italianë, të cilët që më 1904 gjer më 1914, suall një ngjyrë të re në qarket socialiste italiane, po qëkuri të tredhur dhe të klloroformuar prej kurvërisë giolittiane, me Faqet e Lira t' Olivetti-t, Ujkonja e Orano-s, Ardhmënia Shoqrore e Enrico Leone-s.

Më 1919, pasi u-mbarua lufta, socializma nuk ekzistonte më si doktrinë: ajo ishte në gjendje zemërimi dhe s'kish veç se një mundësi, sidomos n' Itali: gjakmarjen dhe dënimin e atyre që kishin dashur luftën

dhe që duhej t' a “shpaganin”. Popolo d' Italia kishte për nën titull “e përditëshme e luftëtarëve dhe e prodhonjësve”. Fjala “prodhonjës” ishte q' at' here shprehja e një drejtimi shpirtor.

Fashizmi nuk pat qënë fryti i një doktrine të para pregatitur në dhomë: ay lindi nga një nevojë veprimi dhe ishte veprim, nuk qe një parti, por, gjatë dy viteve të parë, një kundraparti dhe një lëvizje. Emri q'i jipnja organizimit, i caktonte karakteristikat.

M'anë tjetër, ata që do të rilëçitin raportin e asambles për formimin e Fashiove Italiane t'luftimit, nër fletët tani të fishkura t'asaj kohe nuk do të gjejnë një doktrinë, por një radhitje skicash, paravështrimesh, alluzionesh, të cilat, të çliruara prej pushtesës së domosdoshme të kontigjencave, duhej mbasandaj, pas shumë vitësh, të zhvilloheshin në një varg pozitash doktrinale të cilat e bënë Fashizmin një doktrinë politke të caktuar, në barazim me gjith doktrinën e tjera të së shkuarës ose të tanishme. “Në qoft se borgjezia, thesha at'here, beson të gjejë te neve rrufembrojtësit, ajo gabohet. Ne duhet t'i përvishemi punës... Ne duam t'i stërvitim kllasat punëtore të jenë të zonjat të drejtojnë, makar dhe sa për t'i bindur se nuk është kollaj të drejtohet një industri ose një tregëti. Ne do të lëftojme “prapambetjen” teknike dhe shpirtore...”

Në qoftë se ngadhnim' i regjimit paraqitet, nuk duhet të gjendemi të papregatitur. Duhet të vrapojmë; dhe, në qoftë se regjimi zhduket, ne duhet t'a zëmë vëndin e tij. E drejta e ngadhënjimit është e jona, sepse jemi ne q' e shtymë vëndin në luftë dhe e shpëmë në fitore. Përfaqësimi politik i tanishmë nuk mund të n'a mjaftojë, ne duam një përfaqësim të drejt për drejtë e të gjith interesavet... Dikush mund të thesh për këtë program se

ne vijmë përsëri te korporacionet. Ç'ka të bëjë! Dëshëronja pra q' asambleja të pranonte kërkimet e sindikalizmës Kombëtare në pikëpamjen ekonomike..."

A nuk është çudi që, prej ditë së parë të Piacës San Sepolcro, të tingëllojë fjala "Korporatë", e cila duhej, gjatë Revolucionit, të tregojë një nga Krijimet legislative dhe shoqrore themelore të Regjimit.

2. Zhvillim

Vitet që rodhën para sulmit mbi Romë, ishin vite gjatë të cilëve nevojat e veprimit nuk lejonin as kërkime, as pregatitje doktrinale të plota. Lëftonin nëpër qytetet dhe nëpër fshatrat. Bisedonin, por – ajo q'ish m'e shenjtë dhe më me rëndësi – vdisnin. Dinin të vdisnin. Doktrina – e gatitur, e ndarë në kaptina dhe në paragrafe- mund të mungonte; po, për t'a zëvendësuar, kish diçka më vendonjëse: besimi.

Me gjith ato, mëndja e atyrë që gërmon nëpër librat, artikujt, votimet e kongreseve, nër fjalimet e mbëdhenj e të vegjël, ata që dinë të kërkajnë e të zgjedhin do të shohin se themelet e doktrinës u hodhën në çastin kur lufta kërciste me tërbim. Është pikërisht gjatë këtyre viteve, q'ideja fashiste armatoset, kthjellohet, organizohet.

Problemet e individit dhe të Shtetit; problemet e autoritetit dhe të lirisë: problemet politike dhe shoqrore, edhe ato më krejtësisht kombëtare; lufta kundra doktrinave liberale, demokratike, socialiste, masonike edhe ato të partis Katolike popullore, u bënë njëkohësisht me "ekspeditat dënonjëse".

Por me qënë se "sistemi" mungonte, kundërshtarët e pabesë të fashizmit i'a mohuan ç' do zotësi doktrine, ishte dyke lindur, vërtet në një mënyrë të turbullt, së pari nën

pamjen e një mohimi të rreptë dhe dogmatik – si ç’arin për të gjitha idetë që fillojnë – pastaj nën pamjen pozitive të një ndërtimi, i cili gjente vazhdimisht gjatë viteve 1926-27 dhe 28 realizimin e vehtë në ligjet dhe n’institucionet e regjimit.

Sot fashizmi është i individualizuar jo vetëm si regjim, por edhe si doktrinë. Kjo fjalë duhet interpretuar në kuptimin që sot fashizmi bën kritikën e tij mbi vehtëvehten, dhe mbi të tjerët, në pikëpamjen e tija të veçantë dhe të çquar t’parimeve - prandaj edhe në drejtimet - , për tërë problemet të cilët në fushën e fakteve ose t’ideve, bëjnë të vuajnë gjith popujt e botës.

3. Kundra Pacifizmës: Lufta dhe Jeta si Detyrë

Para ç’do gjëje dhe përsa i përket, në një mënyrë të përgjithëshme, s’arthmes dhe zhvillimit të njerëzimit – dhe në përjashtim të ç’do konsiderimi politik të tanishmë – fashizmi nuk beson as në mundësin as në dobin e paqes së përjetëshme. Ay nuk e pranon pacifizmën, e cila fsheh një frikë kundrejt luftës dhe një poshtërsi përpara sakrificës. Vetëm lufta i ngreh në kulmin e zhvillimit të gjitha energjit njerëzore dhe u vulos një shënjë fisnikërie popujvet që kanë kurajon t’a përballin. Të gjitha provat e tjera nuk janë veç se të radhës së dytë edhe nuk e vënë kurrë njerinë para vehtës së tij, n’kandarin e jetës dhe të vdekjes.

Prandaj një doktrinë e bazuar mbi postulatën e paqes, nuk është më e pajtuarshme me fashizmin, sa ç’nuk janë për spiritën e fashizmit, - edhe sikur të pranohen për pjesën e kufizuar dobija q’ato mund të kenë, në raste politike të caktuara – të gjitha ndërtimet ndërkombëtare të cilat – historia e provon – i mer era, kurse ndjenja, ideali

ose interesi ngjallin fërtunën në zemrën e popujvet. Këtë spiritë antipaqësore fashizmi e vë në veprim edhe në jetën e individëvet. Motoja krenare e çetave goditëse: “Me ne frego”, e shkrojtur mbi lithkën e një plage, nuk është vetëm një profesim fillosofie stoike dhe përmbledhja e një doktrine krejtësisht politike: është stërvitja në luftë, pranimi i rreziqeve q’ajo përmban; është një stil i ri i jetës italiane.

Prandaj fashizmi e pranon, e do jetën, nuk e njeh vehtë-vrasjen dhe shëkon në të një poshtërsi; prandaj e kupton jetën si një detyrë, një naltësim, një ngadhnim: jeta duhet të jetë e naltë dhe e plotë: e rrojtur për ‘të vetë, por sidomos për të tjerët, t’afërm e të largët, të tanishmë dhe t’arthmë.

4. Politika Demografike dhe i “Afërmi” i Ynë

Politika “demografike” e regjimit është rjedhja e këtyre premiseve. Fashisti e do t’ “afërmin” e veht, po ky i “afërmë” nuk është për të një ide e turbullt dhe e pa kuptuarshme: dashuria për t’ “afërmin” nuk zhduk as rreptësitë mirë-ritëse të nevojshme, dhe për shkak më të fortë, as shquarjet dhe largesat. Fashisti i largon përqaqimet e përbotëshme. Por dhe dyke rrojtur në bashkimin e popujve të qytetëruar, i shëkon ndër sy me kujdesje dhe mosbesim, i ndjek në gjëndjen shpirtore të tyre, n’evolucionin e interesave të tyre, edhe nuk e lë vehten të gënjehet prej dukjeve ndryshonjëse dhe gënjeshtare.

5. Kunda Materializmës Historike dhe Luftës së Kllasave.

Një kuptim i ‘tillë i jetës e bën fashizmin mohimin e krenjtë t’asaj doktrine që formonte bazën e socializmës pseudo-shkencore ose marxiste: doktrina e materializmës historike, sipas së cilës historia e qytetimit njerëzor nuk do të shpjegohet veç se nga luftrat interesash midis grupeve të ndryshme shoqrorë si dhe nga shndërrimet e mjeteve të prodhimit.

As njeri nuk mendon të mohojë se faktet ekonomike – zbulime lëndësh të para, mënyrash të reja punimi, shpikje shkencore – kanë rëndësinë e tyre. Por, të pretendohet se mjaftojnë për të shpjeguar historinë njerëzore, në përjashtimin e gjithë faktorëve të tjerë është afërmëndsh: fashizmi beson akoma e gjithnjë në shenjtërinë dhe në trimërinë d.m.th në veprimet në të cilët nuk lot roll as një çestje ekonomike e afërme ose e largme.

Mohimi i materializmës historike, sipas së cilës njerzit nuk janë n’histori veç se figurantë që shfaqen e zhduken mbi sipërfaqe, kurse, në thellësinat, lëvizin e punojnë forcat e vërteta drejtonjëse, shpie në mohimin e luftës së përherëshme dhe të pa evituarshme të kllasave, rjedhje kjo fare natyrale e këti kuptimi ekonomist t’historisë, por më tepër në mohimin e luftës së kllasave e konsideruar si faktor kryesor i shndërrimeve shoqrore.

Socializma, e goditur në këto dy parime themelore të doktrinës saja, nuk mbetet tjetër veç se aspiratë sentimentale e vjetër sa njerëzimi – në një regjim shoqror, në të cilin duhet të lehtësohen vojtjet edhe dhimbjet e më të varfërve. Por këtu, fashizmi e largon iden e “lumtërisë” ekonomike, e cila do të realizohej në mënyrën shoqrore e pothuajse automatikisht në një kohë të caktuar

t'evolucionit ekonomik, dyke u siguruar që të gjithëvet një maksimum mirëqënieje. Fashizmi e hedh poshtë kuptimin materialist e një "lumtërie" të mundur dhe u'a neverit ekonomistëve të gjysmës së partë të shekullit XVIII-të; në vazhdim fashizmi mohon dhe barazimin, mirëqënie=lumtëri, i cili kish për t'i katandisur njerzit në kafshë që s'mendojnë veç se një gjë: të hanë dhe të ngjallen, d.m.th. të kufizuar në një jetë vegjetative.

Pas socializmës, fashizmi u-hyn dorë të gjitha ideologjive demokratike dhe i largon aq në premiset e tyre teorike sa dhe n'aplikimet e tyre praktike. Fashizmi nuk pranon që shumica, prej faktit të vetëm se është shumicë, të mundë t'udhëheqë shoqirinë njerëzore; nuk pranon që ky numur të mundë të qeverisë, me anë të një konsulltimi të përkohëshëm; ay pohon mosbarazimin e paevituarshmë, pjellor dhe mirëbërës të njerëzvet, të cilët nuk mund të bëhen të barabartë me anë të një fakti mekanik dhe të përjashtme, sikundër janë zgjedhjet e përgjithëshme.

Regjimet demokratike mund të shpjegohen kështu: ata në të cilët, kohë pas kohe i jepet popullit illuzioni të pandehet sovran, kurse sovraniteti i vërtetë dhe efektiv, qëndron në të tjera forca, shpesh herë jo përgjegjëse dhe të fshehëta.

Demokracia është një regjim pa mbret, por me mbretër të shumë shpesh herë më satrapë, më tiranikë dhe më çkatrimtarë se sa një i vetëm mbret i cili t'ish një tiran. Kjo shpjegon pse fashizmi, me gjith që kishte, përpara 1922-shit – për çestje kontingjence – shfaqur tendenca republikane, i braktisi para sulmit mbi Romë, i bindur se çestja e formave politike të një Shteti nuk është sot kryesore, edhe se studimi i monarkive të së shkuarës dhe

të tanishme, i republikave të vjetra ose të kësaj kohe, tregon se monarkia dhe republika nuk duhet të gjykohej “sub specie oeternitatis”⁴, por përfaqësojnë forma në të cilat manifestohet evolucioni politik, historia, tradita, psikologjia e një vëndi të caktuar.

Fashizmi ngrihet përmi antitezën monarki-republikë, mbi të cilën demokracia është allavitur mjaft, dyke ngarkuar të parën me gjith të metat dhe dyke paraqitur të dytën si një regjim të mbaruar. Mirëpo, janë parë republika thellësisht reaksionare dhe absolutiste, edhe monarkira, të pranojnë përvoja politike dhe shoqrore nga më të guximshmet.

Arsyeja, shkenca – thesh Renan-i (i cili pati ndriçime parafashiste), në një nga Dialogët fillofike të tij – janë prodhime të njerëzimit por, që të duhash arsyen drejt për së drejti për popullin dhe prej popullit është ëndër. Nuk është nevojë, për qënien e plotë t’arsyes, që bota e tërë t’a kuptojë. Me gjith ato, një i tillë nistim, në qoftë se duhej bërë, nuk do të bëhej prej demokracisë së poshtërt, e cila përkundrazi, duket të sjelli pas, shuajtjen e ç’do kulture të vështirë, edhe të ç’do disipline të lartër...

Parimi sipas të cilit shoqria nuk gjendet veç se për mirëqënien edhe lirin’ e individëve q’e përbëjnë nuk duket në pajtim me pllanet e natyrës, pllane ku vetëm raca është marë parasysh, dhe ku individit duket i sakrifikuar. Është frikë se fjal’e fundit e demokracisë e marë n’ at’ kuptim (nxitohem të them se mund të kuptohet dhe ndryshe) mos të jetë një gjendje shoqrore ku një shumic’ e degjeneruar të mos kish tjetër merak veç se të shijojë qejfet e poshtërt t’harbutit. Kështu flet Renan-i. Fashizmi

⁴ Sipas një perspektive universale. Shënim i redaktorit.

largon, prej demokracisë, gënjeshtren qesharake konvencionale të barazimit politik, spiritën e mospërgjegjesis së përbashkët edhe prrallën e lumtërisë dhe të përparimit të pa caktuar. Por në qoft se demokracia mund të kuptohet në shumë mënyra d.m.th në qoft se demokraci do të thotë mos largim i popullit nga Shteti, fashizmi ka mundur të përkufizohet prej autorëve të këtij libri si “demokraci e organizuar, e qendralizuar, autoritare”.

8. Kundra Doktrinave Liberale

Përkundrejt doktrinave liberale, fashizmi është në një gjendje kundërshtimi të krejtë, si në fushën politike edhe në atë ekonomike. Nuk duhet tepëruar – për shkaqe të thjeshta polemike të tanishme – rëndësia e liberalizmit në shekullin e fundit, dhe, kur ajo nuk ish veç se një nga doktrinat e shumta të mbira në atë shekull, të bëhet një fe e njerëzimit për të gjitha kohët e tanishme ose t’ arthme. Liberalizmi nuk pati veç se pesëmbëdhjetë vjete favorizimi.

Ajo lindi më 1830 si reaksion kundra Lidhjes së Shenjtë e cila desh t’ a risillte Evropën në regjimin e para 1789-ës, edhe pati vitin e saja t’ shkëlqimit më 1848 kur edhe veht Papa Piu i IX ish liberal. Me një her pas filloj dekadencia. Në se 1848-a ish një vit ndriçimi dhe poezie, 1849-a që një mot skëtere dhe tragjedi. Republika Romane u vra prej një tjetër republike, republikës frënge.

Po në atë vit, Marx-i vërvitte ungjillin e fesë socialiste, më të famëshmin Manifest të Komunistëve. Më 1851, Napolon’i III bën kryengritjen e tij antiliberale dhe mbretëron mbi Francën gjer më 1870. Ay u rëzua prej një lëvizjeje popullore, në lidhje me një nga disfatat ushtarake

prej më të mbëdhatë që shënon historia. Fituesi ish Bismark-u, i cili s'e njojt kurrë fen' e lirisë dhe profitët e saj. Është e çuditëshme që një popull me një qytetërim të lartër, si populli gjerman, të ketë injoruar krejtësisht gjatë tërë shekullit XIX, fen'e lirisë. Ay nuk pati veç se një parenthezë, e përfaqësuar prej asaj q'u qojt "Parllamenti qesharak i Francfort-it".

Gjermania ka realizuar unitetin e saj kombëtar në përjashtim të liberalizmës, kundra liberalizmës, doktrinë që duket e huaj në mëndjen gjermane, q'është spiritë krejtësisht monarqike, kurse liberalizma është pragu historik dhe llogjik i anarkisë. Etapet e unitetit gjerman janë të tri luftrat e 1864, 1866, dhe 1870, t'udhëhequra prej "liberalësh" si Moltke dhe Bismark. Sa për unitetin italian, liberalizmi ka pasur aty një pjesë më të dobët në hisen e Mazzini-t dhe të Garibadi-t, të cilët nuk ishin liberalë.

Pa ndërhyrjen e antiliberalt Napoleon, do të mos kishim pasur Lombardinë, dhe, pa ndihmën e antiliberalt Bismark në Sadowa edhe në Sedan, është fare e mundur se do të mos kishim pasur Venedikun më 1866 dhe se në 1870 do të mos kishim hyrë në Romë. Gjatë periudhës 1870-1915, edhe vehtë priftërinjt e Credo-s së re akuzojnë ngrysjen e fesë së tyre: ajo është' e sulmuar pa reshtur në letrësi, prej falimentimit, edhe prej veprimtaris në praktikë.

Veprimizmë: d.m.th nacionalizmë, futurizmë, fashizmë. Shekulli "liberal", pasi grumbulloj një mizëri nyjash gordiane, kërkon t'i zgjidhë me hekatombën e luftës së përbotëshme. Por as një fe nuk dikton një sakrificë aq të tmerëshme. Perëndit e liberalizmës kishin vallë etje gjaku? Tani, liberalizma është dyke mbyllur

portat e tempujvet të saj të shkretuar, se popujt ndjejnë q'agnosticizma e saj në çestje ekonomike, moskujdesim' i saj në çestje politike dhe morale do të sillnin, sikundër ka ngjarë, një shkatrim të sigurt të Shtetevet. Prandaj, që të gjitha përvojat politike të botës së tanishme janë antiliberale dhe është krejt qesharake të duhash t'i radhitësh përjashta historisë; sikur historia t'ish një vënd gjuajtjeje i rezervuar për liberalizmën edhe për profesorat, sikur liberalizma t'ish fjala e naltë dhe e pakrahasuarshme e qytetërimit.

Mohimet fashiste të socializmës, të demokracisë, të liberalizmës, nuk duhet me gjith ato të bëjnë të besohet se fashizmi ka ndërmënd t'a sjellë botën në gjendjen q'ajo ishte përpara 1789-ës, datë q'është marë parasysh si viti i përrurimit të shekullit demo-liberal. Prapa nuk kthehem. Doktrina fashiste nuk ka zgjedhur De Maistre-in për profit. Absolutizmi monarqik e kaloj kohën e veht, sikundër dhe eklesiolatria, si privilegjet feudale ose kastret e mbyllura. Ideja fashiste e autoritetit s'ka të bëjë as pak me Shtetin policor. Një parti që qeveris një komb "tërësisht" është një fakt i ri n'histori.

Afrimet ose barazimet janë të pamundur. Prej gërmadhave të doktrinave liberale, socialiste, demokratike, fashizmi nxjer elementat që kanë akoma një vlerë jetike. Ay duan ç'ka mund të quhen fakte të mbaruar t'historis dhe flak tej kusurin, d.m.th konceptin e një doktrine të mirë për të gjitha kohët dhe për të gjithë popujt.

Po të pranohet se shekull' i XIX të ketë qënë shekull' i socializmës, i liberalizmës, i demokracisë, kjo nuk do të thotë se edhe shekulli' i XX duhet të jetë gjith ashtu shekull' i socializmës, i liberalizmës, dhe i demokracisë.

Doktrinat politike kalojnë, popujt qëndrojnë. Mund të mendohet se shekulli i tanishmë është shekulli i autoritetit, i së “dijathtës”, një shekull fashist; edhe se, në qoftë se shekulli XIX ka qënë shekull’ i individit (liberalizmë do të thotë individualizmë), mund të mendohet se shekulli i tanishmë është shekulli “kolektiv” dhe prandaj, shekull’ i Shtetit.

Është krejt e llogjikëshme që një doktrin’ e re të mundë të përdorë elementat akoma të gjallë të doktrinave të tjera. As një doktrinë nuk mund të pretendojë në një “origjinalitet” të krejtë. Ajo është e lidhur, makar dhe historikisht, me doktrinat e tjera të kaluara, me doktrinat e tjera t’arthme. Kështu dhe socializma e Marx-it lidhet me socializmen utopiste të Fourier-ve, të Owen-ve, të Shën Simon-ve; kështu dhe liberalizma e shekullit XIX lidhet me tërë lëvizjen e “t’iluminuarve” të shekullit XVIII, sikurse doktrinat demokratike janë lidhur me “Enciklopedistët”.

Ç’do doktrinë përpiqet të drejtojë aktivitetin e njerëzvet kundrejt një objektivi të caktuar; por aktiviteti i njerëzvet vepron mbi doktrinën, e ndryshon, e përshtat sipas nevojave të reja, ose e tejkalon. Edhe doktrina vehtë duhet pra të jetë jo një stërvitje verbale por një veprim jete. Q’aty del, karakteri pragmatik i fashizmit, vullnet’ i tija fuqije, vullnet’ i tija të jetojë, pozita e tij kundrejt faktit “dhunë”, dhe e vleftës së tij.

10. Vlera dhe Mision’ i Shtetit

Parimi themelor i doktrinës fashiste është koncepti i Shtetit, i palcës së tij, i rollit tij, i qëllimeve të tij. Për fashizmin, Shteti është absoluti kundrejt të cilit individët edhe grupet nuk janë veç se relativ. Individët dhe grupet

nuk janë të kuptuarshëm veç se brënda Shtetit. Shteti liberal nuk drejton ojnën dhe zhvillimin lëndor e shpirtor të kolektiviteteve, por kufizohet të regjistrojë rezultatet. Shteti fashist është ndërgjegjës, ay ka një vullnet dhe prandaj është i cilësuar Shtet “moral”. Më 1929, n’ asamblen e parë pesëvjeçare të regjimit thesha: “Për fashizmin, Shteti nuk është rojtësi i natës i cili s’kujdeset veç se për mbrojtjen personale t’atdhetarëve. Por nuk është as një organizim me qëllime të krejta materiale, si ay për të garantuar një farë mirëqënieje dhe lidhje shoqrore rrellativisht paqësore, në të cilin rast një Këshill Administrativ do të mjaftonte.

Gjith ashtu nuk është as dhe një krijim politik i thjesht, pa lidhje me realitetin lëndor dhe të ngatruar të jetës s’individëve edhe t’asaj të popujve. Shteti, ashtu si ç’e koncepton dhe e realizon fashizmi, është një fakt shpirtor dhe moral, sepse ay e konkretizon organizimin politik, juridik dhe ekonomik të kombit, dhe ky organizim, në fillimin dhe në zhvillimin e tij, është një shfaqje e mëndjes.

Shteti është garantonjësi i sigurimit të brëndëshme dhe të jashtëme, por është edhe mbrojtësi e përçonjësi i spiritës së popullit, ashtu si ç’është formuar gjatë shekujve në gjuhën, në zakonet dhe në besimin. Shteti nuk është vetëm e tanishmja, por gjith ashtu e shkuara dhe sidomos e arthmja. Është Shteti që, dyke kaluar kufit e ngushta të jetëve individuale, përfaqëson ndërgjegjen e gjallë të kombit.

Format nën të cilat shfaqen Shtetet ndryshojnë, por nevoja qëndron. Është Shteti që formon individët me virtutet qytetare, i bën njohës të misionit tyre, i sjell në bashkim; ay armonizon interesat e tyre me drejtësi; përçon

ngadhnimet e mendimit në fushën e shkencave, t'arteve, të drejtësisë edhe të solidaritetit njerëzor; ay i ngreh njerzit prej jetës elementare të fiseve t'egra në më të naltën shprehje njerëzore të fuqisë, q'është imperatoria; ay përçon gjatë shekujvet emrin e atyre që vdiqnë për tërësin e tij ose për t'u bindur ligjeve të tij; jep për shëmbëll dhe u sugjeron brezave t'arthmë kapedanët që kanë madhuar vëndin e tij edhe gjenit' q'e kanë kurorëzuar me lavdi. Kur kuptim' i Shtetit dobësohet dhe marin vleftë më të madhe tendencat shkatronjëse dhe shpërndarëse t'individëve ose të grupeve, kombet shkojnë në fundin e tyre.

11. Njësia e Shtetit dhe Kundërshtimet e Kapitalizmit

Që më 1919, evolucioni ekonomik dhe politik i përbotëshmë ka forcuar edhe më tepër këtë pozitë doktrinale. Shteti është bërë një gjigand. Është Shteti që mund të zbërthejë kundërshtimet dramatike të kapitalizmit. Kriza nuk mund të zgjidhet veç se prej Shtetit dhe brënda Shtetit. Ku janë hijet e Jules Simon, të cilat, n'agimin e liberalizmës, shpallnin që "Shteti duhet të punojë për t'u bërë i pa nevojshmë dhe të përgatitë dorëheqjen e tij"?

Ku janë hijet e Mac Culloch, të cilat në gjysmën e dytë të shekullit të funtmë, pohonin se Shteti duhet të druhet që të mos qeverisë tepër? Edhe ç'do të thosh, në ndodhjen e ndërhyrjeve të vazhduarshme, të kërkuara dhe të pa evituarshme të Shtetit në çestjet ekonomike, englezi Bentham, sipas të cilit industria nuk duhej t'i kishte kërkuar Shtetit veç se t'a linte rehat; ose Gjermani Humboldt, si pas të cilit Shteti "që s'bën gjë" duhet të konsiderohet si m'i miri?

Është e vërtetë se brezi i dytë i ekonomistëve liberalë që më pakëz ekstremist se i pari dhe se vet Smith'i u apte portën – me gjithë që me kujdes – ndërhyrjeve të Shtetit në fushën ekonomike.

Në qoftë se liberalizëm do të thotë individ, fashizmi d.m.th Shtet. Po Shteti fashist është i vetëm dhe është një krijim origjinal. Ai nuk është reaksionar, por revolucionar, në kuptimin që ai e precedon zgjidhjen e disa problemeve të përbotëshme, të parashtruara gjatë, - në fushën politike prej pjesëtimit të partirave, prej abuzimeve të pushtetit të parlamentarizmit, prej mospërgjigjësisë të Asambleve; - në fushën ekonomike, prej funksioneve sindikale gjithë një më të shumta dhe më të fuqishme, si m'anën punëtore si m'anën patronale, njëkohësisht prej konflikteve ose marrëveshjeve të tyre; - në fushën morale, prej nevojës të rregullit, të disiplinës, të bindjes në rregullat morale të atdheut.

Fashizmi do që Shteti të jetë i fortë, i organizuar dhe të qëndrojë njëkohësisht mbi një bazë të gjërë popullore. Shteti fashist gjithë ashtu ka rivendikuar për vehte fushën ekonomike, dhe më anë të institucioneve korporative, shoqërore, edukatore, që ka krijuar, kuptim i Shtetit arin gjer në degët më të fundit të vëndit dhe, brënda Shtetit, qarkullojnë, të përfshira në organizatat e tyre përkatëse, të gjithë forcat politike, ekonomike dhe shpirtërore të kombit.

Një Shtet që mbështetet mbi miliona individë që njohin, e ndjejnë dhe janë gati të shërbejnë, nuk është Shteti tiranik i “Seigneur”-it të Mesjetës. Ai nuk u ngjet aspak Shteteve absolutiste, të përpara ose pas 1789-ës. Individit në Shtetin fashist nuk është i asgjësuar, por i shumëzuar, sikundër dhe në një regjiment një ushtar nuk është i pakësuar, por i shumëzuar prej numurit të shokëve

të tija të pushkës. Shteti fashist e organizon kombin, po me gjith ato u lë individëve një cep mjaft të gjërë: ay ka kufizuar liritë e padobishme ose dëmprurëse, por ka mbajtur liritë kryesore. Në këtë fushë, vetëm Shteti është gjykonjës dhe jo individi.

12. Shteti Fashist dhe Feja

Shteti fashist nuk ri në moskujdesje as kundrejt çestjes fetare, përgjithësisht, as kundrejt kësaj feje pozitive të veçantë q'është Katolicizma italiane. Shteti nuk ka një teollogji, por ka një moral. Në Shtetin fashist, feja është gjykuar si një nga shfaqjet më të thella të mëndjes, dhe prandaj është jo vetëm e nderuar por e mbrojtur dhe e përkrahur. Shteti fashist nuk krijon për vehte një "Perëndi" të veçantë si ç'desh të bënte Robespierre-i, një çast në kulmin e "çkallimit" të Convention-it; por as që kërkon më kot t'a zhdukë nga shpirtrat, sikundër e bën bollçevizma. Fashizmi nderon Perëndin e asqetëve, të shenjtorëve, të fatosave edhe Perëndin që sheh dhe lut zemra e mitur dhe primitive e popullit.

13. Imperatori dhe Disiplinë

Shteti fashist është një vullnet fuqije dhe sundimi. Tradita romane është aty një ide force. Në doktrinën e fashizmit, imperatoria nuk është vetëm një shprehje tokësore, ushtarake ose tregëtare, por shpirtore dhe morale. Mund të konceptohet një perandori, d.m.th një komb, i cili drejt për drejt ose tërthorazi udhëheq të tjerë kombe, pa qënë për këtë nevoja e zaptimit t'asnjë kilometre të katërciptë tokësore. Për fashizmin, aspirata

për imperatori, d.m.th për zgjerimin e kombeve, është një shprehje vitaliteti: e kundërt' e tij, mëndja e ngushtë, është një shënjë dekadence. Popujt që lindin ose ringjallen janë imperialistë, popujt që vdesin dorëheqës. Fashizmi është doktrina më e përshtatëshme për të përfaqësuar tendencat, gjendjet shpirtore të një populli që, si popull italian, ringjallet pas shekujsh të gjatë braktisjeje ose skllavërie të huaj.

Por imperatoria nevojit disiplinën, pajtimin e mundimeve, detyrën dhe therorinë. Kjo shpjegon pamjet e ndryshme të veprimit praktik të regjimit: drejtimi i dhënë forcave të shumta të Shtetit dhe rreptësia e nevojshme kundër atyre që deshën t'i kundërshtohen kësaj lëvizjeje të vehtvetishme dhe fatale t'Italis së shekullit XX-të, dhe t'i kundërshtohen dyke trazuar ideologjit batalle të shekullit XIX-ë, ideologji të shkeltuara në ç'do vënd, ku është guxuar të bëhen përvoja të mbëdha shndërrimi politik dhe shoqror. Tani më tepër se kurdoherë, popujt kanë etje për autoritet, udhëheqje dhe rregull.

Në qoftë se ç'do shekull ka doktrinën e veht, një mijë fakte n'a tregojnë se ajo e shekullit tanishmë është fashizmi. Fashizmi është një doktrinë jete, sepse ay ka ngjallur një besim; dhe ky besim ka zaptuar shpirtrat, se fashizmi ka pasur të vdekurit dhe dëshmorët e veht.

Fashizmi që tani e tutje, në botën e tërë, ka botërimin që kanë të gjitha doktrinën të cilat, dyke u realizuar, përfaqësojnë një kohë n'historin e mendimit njerëzor.

SHËNIME NË LIDHJE ME KAPTINËN E PARË⁵

⁵ Radhë të nxjera nga botime më të parëshme prej Paraqitjes së Doktrinës së Fashizmit

1. Fashizmi si Fillosofi

“Tani, fashizmi italian, që t’vdesë ose më keq akoma, të vrasë vehten, duhet të marrë një “trup doktrinash”. Nuk do të jetë dhe as që duhet të jetë një xhakë e Nessus-it⁶ që na lidh për jetë të jetëve, sepse e nesërmja është fshehtësir’ e madhe dhe e pa parashëkuarshme, por duhet të jetë një parim që udhëheq veprimtarinë t’onë politike dhe vetiake të ç’do dite. Edhe unë veht q’i kam diktuar, jam i pari q’them se tabllat e thjeshta të këti programi – udhëheqjet teorike dhe praktike të fashizmit – duhen rishëkuar, ndrequr, shtuar, zhvilluar, se këtu-atje kanë pësuar të metat e kohës. Besoj se baza e tyre kryesore është gjithnjë në postullatat të cilat, gjatë dy viteve u kanë shërbyer si shënjë lidhjeje trupave të fashizmit italian, por edhe dyke filluar nga ky kuptim i moçmë, është koha të veprohet me kujdes në një shtjellim të ri dhe më të gjërë të këti programi.

“Në këtë punë jetese, për fashizmin, duhej të bashkëpunonin të gjithë fashistët e Italisë dhe veçanërisht ata të vëndeve ku me marëveshje ose jo – është aritur në një bashkëqenie paqësore e të dy lëvizjeve kundërshtarë.

“Fjala është pakëz e fortë, por desha që, brënda dy muajve që na ndajnë nga Asambleja Kombëtare, të jet krijuar fillosofia e fashizmit. Milano-ja, me shkollën e parë të propagandës dhe kulturës mer pjesë në këtë vepër.

“Nuk është çestja vetëm për të përgatitur elementat e një programi që do të shërbejë si baz’ e shëndoshë për

⁶ Nga mitologjia greke. Këmisha e helmuar që i solli vdekjen Herkulit

organizimin e partisë në të cilën pa tjetër duhet t'arrijë lëvizja fashiste, por duhet gjith ashtu të shkatrohet prralla trashanike si pas së cilës në fashizmin s'ka veç se të krisur, kurse në të vërtetë gjenden edhe shpirtra të merakosura dhe mendonjës.

“Ky drejtim i ri i veprimtaris fashiste nuk’ e pakëson, jam tepër i sigurt, spiritën e shkëlqyer dhe huqin e luftimit, që janë karakteristikat e veçanta të fashizmit. Që të mobillosh trurin me doktrina dhe bindje të shëndosha nuk do të thotë të çarmatosësh veprimin, por t’a forcosh dhe t’a bësh gjithnjë më ndërgjegjës. Ushtarët që dinë përse lëftojnë janë kurdoherë më të mirët. Fashizmi mund të marë për moto dyfjalshin e Mazzini-t: “Mëndje dhe veprim” (Letrë Z. Bianchi, 27 Gusht 1921, me rastin e çeljes së shkollës për propagandë dhe kulturë fashiste në Milano; në : Messaggi e proclami. Milano, lib. d’Italia, 1929. f. 39.)

“Fashistët duhen vënë në lidhje me njëri-tjetrin, dhe vepruar në mënyrë qe veprimtarizm’ e tyre të jetë një veprimtarizmë doktrine, një veprimtarizmë spirite dhe mëndjeje...

“Sikur, kundërshtarët t’anë t’ishin ndodhur në mbledhjen t’onë, do të qenë bindur se fashizmi nuk është vetëm veprim, por edhe mendim” (Në Këshillin Kombëtar të Partis fashiste, 8 Gusht 1924, në vol. Politika e Re e Italisë, edic I IV, Milano, Alpes, 1928, faqe 316-317).

(2) “Sot, pohoj se fashizmi i marë parasysh si ide, doktrinë, realizim, është botnor: Italian, n’institucionet e tija të veçantë, por i përbotëshmë në spiritën e veht, ndryshe nuk mund të jetë. Spirita, prej natyrës ‘saja, është

botnore. Mundet pra të parashikohet një Evropë fashiste, një Evropë që të frymëzohet, n'institucionet e saj, prej doktrineve, prej praktikës së fashizmit, d.m.th. një Evropë e cila të zgjidhë në një mënyrë fashiste problemin e Shtetit modern, të Shtetit të shekullit XX të, I cili është shumë i ndryshëm nga Shtetet q' ekzistonin përpara 1789-ës ose q'u formuan pastaj. Fashizmi u përgjigjet sot ekzigjencave me ngjyrë botnore. Ay zgjidh pra problemin e trifishtë të marrëdhënieve midis Shtetit dhe individit, midis Shtetit dhe grupeve, midis grupesh të pa aaktuar dhe grupesh t'organizuar”

(Mesazh për Vitin e IX, Këshillave Federale të mbledhur në Palazzo Venezia, 27 Tetor 1930, në Scritti e Discorsi dal 1929 al 1931, Milano, Hoepli, 1934, f. 223).

2. Kuptimi Shpirtor

(3) “Ky proces shoqrohet prej një procesi fillosofik. N' është e vërtetë se lënda ka ndenjur gjatë një shekulli përmbi altaret, sot është spirita që ze vëndin e saj. Prandaj të gjitha manifestimet që janë krejtësisht të vehtat e demokracisë janë flakur – braktisja, improvizimet, mungesa e ndjenjës së përgjegjësis personale, lavdërim i numurit edhe i këti diviniteti misterios q' e quhajn “popull” – të gjitha krijimet e spiritës, dyke filluar nga krijimet fetare, janë vendosur në radhën e parë dhe as njeri nuk guxon më të vonohet mbi pozitat e këti antiklerikalizmi, q' ish gjatë dhjetra e dhjetra vitesh, në botën oksidentale, marja e pëlqyer e demokracisë.

“Kur thuhet se Perëndia kthehet, kërkohet të pohohet se vleftat e spiritës kthehen”. (Da che parte va il mondo, në

Gerarchia, a. 1, 1922, N.3; në Scritti e Discorsi, vol. II: La Rivoluzione fascista, Milano, Hoepli, 1934. f. 257).

“Ka një zonë q’është më pak e rezervuar për kërkimin se sa për përsiatjen e qëllimeve më të lartra të jetës. Prandaj, shkenca fillon nga përvoja, por arin pa tjetër te fillosofia, dhe, sipas mëndjes s’ime, vetëm fillosofia mund të ndriçojë shkencën dhe t’a shpjerë n’idenë botnore”. (Në Kongresin e Shkencave të Bologna-s, 31 Tetor 1926, në Scritti e Discorsi dal 1925 al 1926, Hoepli 1934).

“Që të kuptohet, lëvizja fashiste duhet konsideruar në tërë gjërësin dhe në tërë thellësin të fenomenit shpirtor ‘saja. Shfaqjet e tija praktike kanë qënë nga më të fuqishmet dhe më vendonjëset, por nuk duhet që të kufizohet i gjithë kujdesi i ynë vetëm nër’ to. Me të vërtet, fashizmi italian nuk ka qënë vetëm një rebellizmë politike kundra qeverive të dobëta dhe të pa zonja që kishin lënë të bjerë në dekadencë autoritetin e Shtetit dhe kërcënonin t’a qëndronin Italinë mbi udhën e zhvillimit saj, por ka qënë një kryengritje shpirtore kundra ideologjirash të vjetra që shprishnin parimet e shenjta të fesë, t’atdheut dhe të familjes. Fashizmi ka qënë pra një manifestim drejt për së drejti popullor”. (Një mesagj popullit englez, 5 Janar 1924, në Messagi e Proclami, Milano, Lib. d’Italia, 1929, f. 107).

3. Kuptimi Pozitiv i Jetës si Luftë

(4) “Lufta është n’origjinën e ç’do gjëje, sepse jeta është e tëra plot kundërshtime: është dashuria dhe hurrejtja, e bardha dhe e zeza, dita dhe nata, e mira dhe e liga, dhe gjer sa këta kundërshtime nuk do të gjejnë ekuilibrin e

tyre, lufta do të jetë gjithnjë në thelbin e natyrës njerëzore si një fatalitet m'i lartër.

“Fundja, është mirë që ngjet kështu. Sot mund të kemi luftën, luftën ekonomike, luftën e ideve, por dita kur do të mos ketë më luftë, do t'ish një ditë melankolije, fundi, shkatrimi. Mirë po, ajo ditë s'ka për t'ardhur, pikërisht se historija paraqitet gjithnjë si një panoramë ndryshonjëse.

Po të pretendohej kthimi në qetësinë, në paqen, n'urtësinë do të lëftoheshin tendencat e periudhës dinamike të tanishme. Duhet m'u përgatitur për të tjera gjëra të papritura, për të tjera luftëra. Nuk do të ketë periudhë paqeje, gjersa popujt nuk do të braktisen, në një ëndër Kristiane vllazrimi botnor dhe që nuk do të mundin të zgjatin dorën njëri tjetrit që përtej oqeanëve dhe maleve. Për vehte t'ime, nuk para u besoj aq këtyre idealiteve, por as që I përjashtoj, sepse unë nuk përjashtoj asgjë”. (Fialim në Politeama Rossetti di Trieste, 20 Shtator 1920; në Scritti e Discorsi, vol. II.: La Rivoluzione fascista Hoepli 35).

(5) “E Kuptoj nderin e Kombeve në Kontributin q'i kanë dhënë kulturës së njerëzimit”. (E. Ludwig, Bashkëfjalime me Mussolinin, Milano, Mondadori, 1932, f. 199).

4. Kuptimi Moral

(6) “E kam quajtur për kundrazi këtë organizatë: “Fashiot italianë të luftimit”. Në këtë fjalë të rëndë dhe metalike, përmbledhej tërë programi fashizmit ashtu si ç'e ëndëronja, si ç'e desha, dhe si ç'e bëra.

“Shokë, ja se cili është akoma program'i ynë: luftimi.”

“Për ne fashistët jeta është një luft’e vazhduarshme dh’e pasosur, të cilën e pranojmë, me një qetësi të madhe, me një kurajo të madhe, me trimërin e nevojshme”. (Në Romë: Për të VII., përvjetor të themelimit të Fashiove, 28, Mars 1926; në Scritti e Discorsi dal 1925 al 1926, Hoepli, 1934, f.287).

“Po vijmë përsëri mu në palcën e fillosofis fashiste. Kur një fillosof finlandss m’u lut aty përpara t’i jap, në një frazë, kuptimin e fashizmit, shkrojta gjermanisht: “Neve jemi kundra jetës së rehatëshme!” (E. Ludwig: Bashkëfjalime me Mussolinin, Milano, Mondadori, 1932, f. 190).

5. Kuptimi Fetar

(7) “Po të mos ishte fashizmi një besim, qysh do t’u jepte nxënësve të veht stoicizmën dhe kurajon? Vetëm një besim që ka aritur lartësimin e një feje, mund të sugjerojë fjalët e dala nga buzët tani të fishkura të Federico Florio-s”. (Lidhje gjaku në Popolo d’ Italia të 19 Janarit 1922; edhe në Scritti e Discorsi, vol. II: La Rivoluzione fascista, Hoepli, 1934, f. 231).

6. Kuptimi Moral dhe Realist

(8) “Tradita është sigurisht një nga forcat më të mbëdha shpirtore të popujvet, gjer sa është një krijim i rjedhëshme dhe i pa tundur i shpirtit tyre”. (Breve preludeo, në Gerarchia, a. I, 1922, N.1 dhe në Tempi della rivoluzione fascista, Alpes 1930).

(9) “Temperament’i ynë na shtyn të kqyrim pamjen konkrete të problemeve, dhe jo zgjerimet e tyre ideologjike dhe mistike. Prandaj ne e gjejmë lehtazi

drejtpeshimin”. (Pamje të dramës, në Popolo d’ Italia të 31 Tetorit 1917).

“Lufta jonë është m’ e papëlqyershme, por është m’ e bukur se na detyron të mos varim besimin veç se mbi forcat t’ona. Ne i kemi dërmuar të gjitha të vërtetat e zbuluara, kemi pështyrë mbi të gjitha dogmat, kemi flakur tërë parajsat, kemi tallur të gjithë sharllatanët – të bardhë, të kuq, të zinj – që kllasin në tregëtinë ilaçet çudibërës të cilët do t’i sjellin “lumtërinë” racës njerëzore. Neve nuk besojmë as në programet, as në pllanet, as në shenjtorët, as n’apostujt dhe haq më tepër ne s’besojmë as në lumtërinë, as në shpëtimin.

“Ne nuk besojmë në një zgjidhje të vetëme, qoft ekonomike, politike ose morale, në një zgjidhje të vijuarshme të problemeve të jetës, sepse – o të famëshme psalltër – jeta nuk është e vijuarshme edhe s’kini për t’a katandisur kurrë në një pjesë të përçarkuar prej nevojash kryesore” (Në Diuturna, f. 223. Popolo d’ Italia, 1 Janar 1922.)

(10) “Ne, nuk jemi, edhe as që duam të jemi mumje të ngurosura përjetësisht, me fytyrën gjithnjë të kthyer në një horizont të vetëm, por dhe as që duam të mbyllemi në kufit e ngushta t’ adhurimit të tepëruar shkatrimtar, ku përsëriten mekanikisht formula të njëjta me lutjet e feve të profesuara; por neve jemi burra, dhe burra të gjallë, që duam të sjellim kontributën t’onë, sa do modeste qoftë, për krijimin e historisë”. (Guxim, në Popolo d’Italia 15 Nëntor 1914 në Scriti e Discorsi, vol. 1)

“Ne përdorim vlefte morale dhe tradicionale, që socializma s’i përfill dhe i përbuz; por para së gjithash

spirita fashiste urren ç' do gjë q' është hypothekë arbitrare mbi t' arthmen misterioze". (Pas dy viteve, në Popolo d' Italia 23 Mars 1921).

“Në ndodhjen e fjalëve dhe t'ideve konservimi dhe rindërtimi, tradite dhe përparimi, që formullohen më të djatht' e më të mëngjër, ne nuk i mvaremi të dëshpëruar së shkuarës, si një drasë e fundit shpëtimi por dhe as që Idhemi pa u menduar në mirazhet gënjyse të s' arthmes”. (Breve Preludio (1922), cit. Në Kohë të revolucionit fashist.Milano, Alpes, 1930. f. 14).

“Mohimi, moslëvizja e përjetëshme, është mallkimi: Unë jam për lëvizjen. Jam një ecës përpara.) (E. Ludwig. Bisedime me Mussolini-n, f, 204.)

7. Anti-individualizmë dhe Liri

(11) Ne jemi të parët që kemi pohuar, në ndodhjen e individualizmës demo-liberale se individi nuk gjendet veç se gjer në masën q'është brënda Shtetit dhe i subordinuar në nevojat e Shtetit, dhe se, ndërsa qytetërimi mer forma sa vjen më të ngatruara, liria e individit kufizohet gjithënjë më tepër.” (Në raportin e madh të fashizmit, 14 Shtator 1929, në Fjalime të 1929-ës, Milano Alpes 930).

“Kuptim' i Shtetit madhohet në ndërgjegjen e Italianëve, që ndjejnë se vetëm Shteti është garantia e domosdoshme e unitetit dhe e pamvarësis së tyre; që vetëm Shteti përfaqëson vazhdimin në t'arthmen të racës së tyre dhe t' historisë”. (Mesagj i përvjetorit VII, 25 Tetor 1929.)

Në se gjatë 80 vjeteve që kanë rjedhur, kemi realizuar përparime aq të mbëdha, e mendoni dhe mund të pandehni dhe paravështroni se, në 50 ose 80 vjet, udha e bërë prej

Italisë, prej kësaj Italie që ne e ndjejmë aq të fuqishme, aq plot me gjallëri, do të jetë me të vërtet madhështore, sidomos kur bashkimi qëndron midis gjith atdhetarëve, në se Shteti vazhdon të jetë arbitri në mosmarëveshjet politike dhe shoqrore, në se ç’do gjë është brenda Shtetit dhe as gjë përjashta Shtetit, sepse, sot, nuk konceptohet një individ përjashta Shtetit, veç se individi i egërt i cili nuk mund të rivendikojë veç se vetëmin dhe shurin e shkretëtirës.” (Fjalimi në Senat 12-5-28).

“Fashizmi i ka kthyer Shtetit aktivitetin e tija sovran. Ka rivendikuar, kundra gjith partikullarizmave kllasash dhe kategorish, vlefën morale të Shtetit; I ka kthyer Qeveris së Shtetit, të ulur në rollin e një vegle zbatonjëse t’asambles së zgjedhur, dinjitetin e vehtë të një përfaqësonjëse të personalitetit të Shtetit dhe tërësin e fuqis saja t’urdhimit; ka pastruar administratën nga influencat e të gjitha fraksioneve dhe nga gjith interesat.” (Në Kshillin e Shtetit, 22 dhjetor 1928, sic, f. 358.)

(12) “Mos mendoni të mohoni karakterin moral të Shtetit fashist, se do të kisha turp të flisnja që nga kjo tribunë, po të mos ndjenja se përfaqësoj forcën morale dhe shpirtrore të Shtetit. Ç’do t’ ishte Shteti po të mos kish spiritën e vehtë, moralin e vehtë, gjë q’ u jep fuqi ligjeve të tij dhe me anë të së cilave arin që t’i binden të gjith qytetarët?

“...Shteti fashist rivendikon plotësisht karakterin e tija moral: ay është Katolik, por para së gjithash është fashist, kryesisht fashist dhe vetëm fashist.

“Katolicizma bën pjesë në ‘të dhe e deklarojmë haptazi, por as njeri nuk duhet të mendojë të ngatrojë kartrat me finokërira fillosofike ose metafizike. (Fjalim në Dhomën

e Deputetëve, 13 Maj 1929. Akordet e Latran-it. Romë. Lib. del Littorio, 1929, f. 106. Shih gjith ashtu: Scritti e Discorsi, vol.: VII, Milano Hoepli, 1934, faqe 31).

“...Një Shtet q’është vehtënjuhës i misionit veht dhe që përfaqëson një popull në përparim, një Shtet q’e tranformon vazhdimisht këtë popull, edhe në pamjen e tija fizike. Shteti duhet t’i thotë gjëra të mbëdha këti populli, të trazojë ide të mbëdha dhe probleme të mbëdhenj, dhe jo të bëjë vetëm administrim ordinar”

(13) “Koncept’i liris nuk është absolut, sepse, në jetë, s’ka as gjë absolute. Liria nuk është një e drejtë, por një detyrë. Nuk është një dhoratë: është një ngadhnim; nuk është një barazi, është një privilegj. Koncept’i liris ndryshon me kohët. Ka liri në kohë paqeje, që nuk është më ajo liri e kohës s’luftës. Ka një liri në kohë pasurie, që s’mund t’ akordohet në kohë vobekësie.” (Përvjetor i V-ë i Themelimit të Fashiove 24 Mars 1924: Politika e re e Italis; III, Fjalime të 1924.)

“Në Shtetin t’ onë, liria nuk I mungon individit. Ay e zotëron më tepër se njeriu i vetëmuar: me qënë se Shteti e mbron, ay është një pjesë e Shtetit. Njeriu i vetëmuar mbetet pa mbrojtje. (E. Ludëig, Bisedime me Mussolini-n, f. 129.)

(14) “Sot, i njoftojmë botës së tërë, krijimin e Shtetit të fuqishmë unitar Italian, që nga Alpet gjer në Sicilje, dhe ky Shtet shprehet në një demokraci të qendralizuar, unitare, në të cilën populli qarkullon pas dëshirës. Me të vërtetë, Zotrinj, ose e vini popullin brënda Kështjellës së Shtetit, dhe ay do t’ a mbruajë, ose do të mbetet përjashta,

dhe do t'a msyjë.” (Në Dhomën e Deputetëve, 26 Maj 1927, në Fjalime të 1927, f. 159.)

“Në regjimin fashist, njëjësimi i të gjitha kllasave, njëjësimi politik, shoqror dhe moral i popullit italian realizohet brënda Shtetit edhe vetëm në Shtetin Fashist.” (Në Dhomën e Deputetëve, 9 Dhjetor 1928: Fjalime të 1928, f. 333).

8. Antisocializmë dhe Korporativizmë

(15) “Kemi krijuar Shtetin unitar Italian. Mendoni se që në kohë t' imperatoris romane, Italia nuk kishte më një Shtet unitar. Këtu, pohojmë përsëri solemnisht doktrinën t' onë mbi Shtetin. Këtu, pohoj përsëri dhe jo më pak energjikisht, formulën e fjalimit t'im në Scala të Milanos: “Gjithëçka brënda Shtetit, asgjë kundra Shtetit, asgjë përjashta Shtetit”. (Në Dhomën e Deputetëve, 26 maj 1927. në Fjalimet e 1927, f. 157).

(16) Jemi pra në një Shtet që kontrollon të gjitha forcat që veprojnë në gjirin e Kombit. Ne kontrollojmë forcat morale, ne kontrollojmë forcat ekonomike, jemi pra krejtësisht në një Shtet korporativ fashist...

Ne përfaqësojmë një parim të ri në botë, ne përfaqësojmë antithezën e qartë, kategorike, të përsosur të demokracisë, të pllutokracisë, të masonerisë, me një fjalë, e të gjith asaj bote të parimeve të pavdekëshme të 1789-tës” (Për vendosjen e Këshillit Kombëtar të Partisë, 7 Prill 1926.)

“Ministria e Korporatave nuk është një organ burokratik, por edhe as që mendon të zëvendësohet n' organizatat sindikale në veprimin e tyre domosdo vetqeveritar, që përpiqet t'përfshijë, të zgjedhë dhe të përmirësojë

pjesëtarët e veht. Ministria e Korporacioneve është organi me anën e të cilit si në qendër dhe në periferi, realizohet korporata e tërë dhe vendoset ekuilibri midis interesave dhe forcave të botës ekonomike. Ky realizim është I mundur, në fushën e Shtetit, sepse, vetëm Shteti ngrihet lart interesave në kundërshtim t' individëve dhe të grupeve për t'i pajtuar në një qëllim më të lartër dhe është I lehtësuar nga fakti se të gjitha organizimet ekonomike të njojtura, të garantuara dhe të mbrojtura në Shtetin Korporativ, rrojnë në qerthullin e përbashkët të fashizmit: d. m. th. pranojnë konceptin doktrinal dhe praktik të fashizmit. (N'përrurimin e Ministris së Korporatave, 31 Korrik 1926).

“Kemi bërë Shtetin korporativ dhe fashist, Shtetin e shoqris kombëtare, Shtetin që qendralizon, kontrollon, harmonizon dhe zbut njëkohësisht interesat e të gjitha kllasave shoqrore, që janë gjith ashtu edhe të mbrojtura. Dhe kurse më parë, gjatë viteve të regjimit demo-liberal, shumicat punëtore q' e shihnin Shtetin me mosbesim, ishin përjashta Shtetit, ishin kundra Shtetit, e gjykonin Shtetin si një armik të ç' do dite dhe të ç' do ore, sot, s' ka një italian që punon, që të mos kërkojë vëndin e veht në korporatat, në federatat, që të mos dojë të jetë një zë' i gjallë i kësaj organizme, tërë jetë e madhe dhe pa kufi q' është Shteti kombëtar korporativ fashist.” (Për të IV përvjetor të Sulmii, prej ballkonit të Pallatit Chigi, 28 Tetor 1926).

9. Demokraci dhe Komb

(17) “Lufta ka qënë “revolucionare” në kuptimin q'ajo i ka dhënë fund – në lumenj gjaku – shekullit të

demokracisë, shekullit të numurit, të shumicës, të sasisë.”
(Më ç’ anë vete bota, në Gerarchia, 1922 dhe në Kohë të
Revolucionit fashist, f. 37)

(18) Shih më sipër shënimin 13.

(19) “Raca: është një ndjenjë dhe jo një realitet: 95%
ndjenjë.” (E. Ludwig: Bisedime me Musolini-n, f. 75.)

10. Kuptim’ i Shtetit

(20) “Një komb gjendet gjer në masën q’është një popull.
Një popull lartësohet kur është i shumtë, punëtor, i
organizuar. Fuqija është rjedhja e këti trifjalshi themelor.”
(N’ Asamblen’ e përgjithshme të Regjimit, 10 Mars
1929.)

“Fashizmi nuk e mohon Shtetin; ay pohon se një shoqri
civike kombëtare ose perandorake nuk mund të
konceptohet veç se nën formën e Shtetit.” (Shtet, anti
Shtet, Fashizmë, në Gerarchia, 25 Qershor 1922 dhe në
Kohë të Revolucionit fashist, f. 94.)

“Për neve, Kombi është më tepër spiritë dhe jo vetëm tokë.
Ka Shtete që kanë pasur toka të pakufizuarshme dhe që
s’kanë lënë asnjë shënjë n’historin e njerëzimit. Nuk është
vetëm numuri, sepse ka pasur n’histori, Shtete fare të
vegjël, mikroskopikë, që kanë lënë dokumenta të
rëndësishme, të pavdekëshme, n’art dhe në fillosofi.

“Madhëria e Kombit është një përbashkim i të gjitha këtyre
energji, i të gjitha këtyre konditave. Një komb është’ i
madh kur e kthen në realitet forcën e spiritës së veht.”
(Fjalim Napoli, 24 Tetor 1922; Fjalimet e Revolucionit.
Milano, Imperia, 1923, f. 58).

“Ne duam t’ a njëjësojmë Kombin në Shtetin sovran, i cili është mbi të gjithë dhe mbase kundër të gjithëve, sepse përfaqëson vazhdimin moral të Kombit n’ historinë. Pa Shtetin, kombi nuk gjendet; nuk ka veç se agregata njerëzore, që pësojnë gjith copëtimet q’ historia mund t’ u japë si dënim”. (Në Kshillin Kombëtar të Partis fashiste, 8 Gusht 1924; Politika e re e Italis, Milano, Alpes, 1928, f.319.)

11. Një Shtet Moral

(21) “Besoj se popujt...në duan të rojnë, duhet të zhvillojnë një farë vullnet fuqie; për ndryshe, rrojnë një jetë të ngurosur, fatkeqe, të varfër dhe do të jenë gjahu i një populli më të fortë i cili do të ketë zhvilluar më tepër në vehten e tij këtë vullnet fuqie.” (Fjalim në Senat, 28 Maj 1926).

(22) “Është fashizmi që ka riformuar karakterin e italianëve, dyke zhdukur prej shpirttrave t’ anë ç’do njollë të ndotur, dyk’ e ngjyer atë karakter me të gjitha sakrificat, dhe dyke i dhënë kështu fytyrës italiane pamjen e saja të vërtetë, force dhe bukurie.” (Fjalim në Pisa, 25 Maj 1926; në Fjalime të 1926, f. 193).

“Nuk është jasht bisedës të lavdërojmë karakterin e përbrendshëmë, kuptimin e thellë të ngritjes fashiste. S’është fjala vetëm për një ceremoni, po për një çast me shumë rëndësi të sistemit t’ edukimit dhe të përgatitjes tërësore dhe integrale të njeriut italian, që Revolucioni fashist konsideron si një nga detyrat themelore te Shtetit. Në qoftë se Shteti nuk e përmbush këtë detyrë ose pranon, me ç’do mënyrë qoftë, t’ a bisedojë, pa tjetër ve n’rrezik

të drejtën e tija për jetesë.” (Në Dhomën e Deputetëve, 28 Maj 1928; në Fjalime të 1928, f. 68.)